



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1833 / Prot.

2

Tiranë, më 15.11 /2018

V E N D I M

Nr. 20 datë 15.11.2018

“PËR

MIRATIMIN E TARIFAVE TË REGJISTRIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019 PËR PROGRAMET E STUDIMIT NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS”

Në mbështetje të nenit 3, pika 3, gërmat a dhe ç, 47 dhe nenit 109 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr.13, datë 17.11.2016 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, Vendimin e Senatit nr.12, datë 30.10.2018, si dhe me propozim të Administratorit të Institutit, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Të miratohet tarifat e regjistrimit për programet e studimit në Universitetin Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2018-2019, si më poshtë:
 - a) Tarifat e regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve në shumën 1600 (njëmijë e gjashtëqind) lekë;
 - b) Tarifa e regjistrimit në programet e ciklit të dytë të studimeve në shumën 2500 (dymijë e pesëqind) lekë;
 - c) Tarifa e regjistrimit për programet e dyta të studimit në shumën 3000 (tremijë) lekë;
 - d) Tarifa e regjistrimit për transferimin e studimeve në shumën 3000 (tremijë) lekë.
 - e) Tarifa e regjistrimit për kandidatët nga trojet shqiptare në shumën 2000 (dymijë) lekë.
2. Ngarkohen Administratori i Institutit dhe njësitë kryesore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

PLARENT DRECA

